

**STATUT I SHOQERISE**  
**"GREEN on REPEAT" Sh.P.K.**

Ky Statut do tē konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 24/11/2018, personat e me poshtem:

**Znj. Irena Kita**, shtetase shqiptare, e bija e Andrea, lindur me 03.01.1982 ne Permet e banuese ne Tirane, mbajtse e leternjofitimit me nr. 028708249 dhe nr. personal I25103049A, madhore e me zotësi të plotë juridike e për tē vepruar;

Dhe

**Z. Ermal Hysesani**, shtetas shqiptar, lindur me 22.05.1990 ne Memaliaj, Tepelene e banues ne Tirane mbajtse i leternjofitimit me nr. 032568588 dhe nr. Personal J00522039U, madhor e me zotësi të plotë juridike e për tē vepruar,

Si edhe

**Z. Arvin Kita**, shtetas shqiptar, lindur me 01.10.1972 ne Tirane e banues ne Tirane, mbajtse i pasaportes me nr. BG3480084 dhe nr. Personal H21001147H, madhor e me zotësi të plotë juridike e për tē vepruar,

ne perputhje me LigjinNr.9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratuan kete Statut si vijon:

Në këtë statut

- "Ligi" është Ligji 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është ky Statut i Shoqërisë;

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 24/11/2018, ne, themeluesit e mesiperm, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kuqizuar me emrin dhe emertimin tregtar "**GREEN on REPEAT" SH.P.K.**

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do tē kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- *Sherbime cateringu, hapje dhe menaxhim baresh, restorantesh, etj; hapje kursesh profesionale ne fushen e gastronomise dhe menaxhimit; eksportimi dhe importimi i makinerive dhe pajisjeve gastronomike, eksportimi dhe importimi i mallrave ushqimore/industriale te ndryshme, pijeve alkoolike e jo-alkoolike me shumice e pakice si brenda dhe jashte vendit.*



- *Ne funksion te qellimeve te mesiperme Shoqeria mund te hyje ne tregje dhe operacione te ndryshme, te zoteroje pasuri te luajtshme e te paluajtshme dhe/ose pjesemarrje ne shoqeri te tjera tregtare.*
- *Shoqeria mundet gjithashtu te ushtroje cdo lloj tjeter biznesi apo aktiviteti te ligjshem dhe/ose mund te angazhohet ne cdo veprimtari te ligjshme ose aktivitet te lejueshem nga legjislacioni shqiptar ne fuqi per nje shoqeri me perqjegjesi te kufizuar.*

#### Neni 3

##### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e *pacaktuar dhe/ose e pakufizuar*.

#### Neni 4

##### Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: *Rruga "Ymer Kurti", nr. 4, Njesia bashkiake nr. 5, Qendra Tregtare Olimpia, kati 0, pas Postes nr. 8, Tirana, Shqiperi.*

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

#### Kreu II

##### Kapitali

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njeqind mijë) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Ermal Hysesani**: Zoterues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 60.000 LEK që përben **60% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.
2. Ortakja themeluese **Irena Kita**: Zoteruese e **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 20.000 LEK që përben **20 % të kapitalit themeltar të shoqërisë**.
3. Ortaku themelues **Arvin Kita**: Zoterues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme 20.000 LEK që përben **20% të kapitalit themeltar të shoqërisë**.

Kontributi i ortakëve është në para.

Secili ortak do te kete një numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

#### Neni 6

##### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të tritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen përndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve si dhe nëpërmjet trashëgimisë.

Çdo transferim i pjesëve te kapitalit ndaj personave te trete, ne çfaredo menyre, si dhe krijimi i çdo te drejte reale apo garancie mbi pjeset e kapitalit ne favor te paleve te treta, duhet te miratohet paraprakisht nga Asambleja e Ortakeve, ne te kundert do te jete i pavlefshem.

Secili ortak ka te drejten e parablerjes ne rast transferimi te pjesëve te kapitalit te ortakeve te tjere. Ortaku transferues detyrohet te njoftoje te gjithe ortaket e tjere ne lidhje me kushtet thelbesore te transferimit dhe t'i jape atyre nje afat prej 30 (tridhjete) ditesh per te vendosur nese do te ushtrojne apo jo te drejtat e tyre te parablerjes. Ortaket qe vendosin te ushtrojne te drejten e parablerjes duhet te njoftojne ortakun transferues brenda afatit te mesiperm. Me kalimin e afatit te mesiperm, ortaket qe nuk kane njoftuar ushtrimin ose jo te se drejtes se parablerjes, do te prezumohet se nuk deshirojne ta ushtrojne ate. Ne varesi te numrit te ortakeve qe ushtrojne ose jo te drejten e parablerjes, me mbarimin e afatit 30 ditor, secili ortak do te fitoje proporsionalisht me pjeset e zotuara prej tij, pjeset e kapitalit qe transferohen nga ortaku transferues. Nese asnje ortak nuk ushtron te drejten e parablerjes, ortaku transferues mund t'i transferoje pjeset e kapitalit ne favor te çdo personi te trete ne te njejtat kushte esenciale me ato te ofruara ortakeve te tjere si me siper.

#### **KREU III**

##### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton edo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te peraktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zvadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) shperndarjen e fitimeve vjetore;
  - j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë sì përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9**

#### **Mënyra e Thirrjes se**

#### **Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët më të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 51 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se 51 perqind te kuotave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

#### **Neni 11**

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e

shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpérblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB për të pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### Neni 12

##### Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuari, i autorizuar vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

#### Neni 13

##### Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit eshte 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat të plotë 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- **Znj. Albana Copani**, shtetase shqiptare, lindur me 24.09.1990 ne Tirane e banuese ne Tirane, mbajtese e pasaportes me nr. BD0829997 dhe nr. Personal J05924067L, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, nr. kontakti: 0697080234, *pa kufizime ne kompetencat e administrimit.*

#### Neni 14

##### Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësijnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjeter aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

c) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim a mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar



kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme: u kthen ortakëve kontributet; u paguan ortakëve interesa apo dividendë; u shpérndan aktivet shoqërisë; lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin finanziar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesës nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkese padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### **Kreu IV**

##### **Viti finansiar-ekspertet**

###### **Neni 16**

###### **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

###### **Neni 17**

###### **Ekspertet**

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithe vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

#### **Kreu V**

##### **Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë**

###### **Neni 18**

###### **Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund tē behet ne cdo kohe: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim tē Asamblese se Ortakeve; me hapjen e procedurave tē falimentimit; në përputhje me pikën 3 tē nenit 43 tē ligjit 9723/2007; me vendim tē gjykatës. Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne tē cilin parashikojne menyren e likuidimit tē shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument tē nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tē likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim tē rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për tē caktuar një likuidues.

#### **Neni 19**

#### **Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund tē ndahet, bashkohet sipas Vednimit tē Mbledhjes së Përgjithshme tē Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore tē parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 20**

#### **Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqipërise.

#### **Neni 21**

#### **Mosmarrëveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqërise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

*Për ndjekjen e procedurave te regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit, autorizohet Znj. Brunilda Hasko dhe /ose Z. Ambriela Vallaj dhe/ose Znj. Hyri Ramaj, te cilat mund te veprojne vecmas njera tjeteres dhe autorizohen shprehimisht nga ortaket dhe administratorja per regjistrimin e shoqerise ne regjistrin tregtar shqiptar.*

Ky akt, u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua, nga ortakët themelues si vijon:

**ORTAKËT**  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"GREEN On REPEAT"Sh.P.K.**

Znj. Irena Kita



Z. Ermal Hysesani



Z. Arvin Kita



Fernal Hysen

rene falk  
CJ

ANITA KOTH  
AK

AB